



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju

Kosovo Accreditation Agency

Data: 11.08.2017

Ref.: 630/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa nr.548/17, datë 14.07.2017 e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Mjekësisë në Prishtinë për rishqyrtim te vendimit te KSHC-së nr.563/17, datë 06.07.2017.
- II. Shfuqizohet vendimi i KSHC-së nr.563/17, datë 06.07.2017 për pezullim te akreditimit të programit të studimit: Mjekësi Paraklinike, PhD, 180 ECTS, të Fakultetit të Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.
- III. Lejohet regjistrimi i studenteve ne programin studimit: Mjekësi Paraklinike, PhD, 180 ECTS.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsy etimi


Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Mjekësisë me 14.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim te vendimit te KSHC-së nr. 563/17, datë 06.07.2017, me te cilin vendim Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit të Mjekësisë i është pezulluar akreditimi për programin e studimit: Mjekësi Paraklinike, PhD, 180 ECTS.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit te dorëzuar (me datë 14.07.2017) nga Universitetit të Prishtinës, Fakultetit i Mjekësisë, KSHC ka konstatuar që programi i studimit Mjekësi Paraklinike, PhD, 180 ECTS, i plotëson kushtet sa i përket stafit akademik që parashihen me Udhëzimin Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, nenit 11, pika 3.2. Bazuar në dispozitat e cekura me lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Mjekësisë;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

